



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 2.10.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR MIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT “PËR PROCEDURËN PARAPRAKE TË PËRZGJEDHJES SË TRE ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 2 tetor, në mbështetje të neneve 19 dhe 32-38 të Rregullores së Kuvendit, nenit 44, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, diskutoi projektvendimin “Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në funksion të parimit të transparencës dhe interesit për vetofrimin e kandidaturave, në zbatim të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, ku përcaktohet qartë procedura e zgjedhjes së organeve kushtetuese ose të krijuara me ligj dhe në vëjimësi të procedurës së ndjekur në vitin 2014, vendosi ti propozojë për miratim seancës plenare projektvendimin ku përcaktohen procedurat paraprake për zgjedhjen e kandidatëve për tre vëndet vakante, për anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Komisioni vendosi që projektvendimi të përcaktojë hapat që do të ndiqen nga shërbimet e Kuvendit, përsa i përket bërjes publike të vakancës, procedurave që nga depozitimi i dokumentacionit, zhvillimi i seancës dëgjimore e deri në depozitimin e kandidaturave që do të propozohen nga të paktën 28 deputetë. Gjatë diskutimeve anëtarët e Komisionit theksuan faktin se, procedura paraprake e propozuar nuk është e detyrueshme për tu ndjekur nga deputetët, 28 prej të cilëve mund të propozojnë një kandidaturë tjetër jashtë procedurës së sipërcituar.

Komisioni në përfundim të mbledhjes vendosi unanimisht ti dërgojë seancës plenare për votim projektvendimin që i bashkëlidhet këtij raporti.

KRYETARI

Erjon BRAÇE